

Deklaratë e Përbashkët

mbi themelimin e Zyrës së Bashkëpunimit Rinor Rajonal të Ballkanit Perëndimor

Ne, kryeministrat e vendeve pjesëmarrëse të Ballkanit Perëndimor, në takimin e Vjenës, në kuadër të Konferencës mbi Ballkanin Perëndimor, në prani të

- Duke pasur parasysh objektivin e vendosur në “Procesin e Berlinit” për të zgjeruar shkëmbimet ndërmjet vendeve, në veçanti midis të rinjve,
- Me synimin për të bërë më thelbësor bashkëpunim rajonal me anë të identifikimit të interesave të përbashkëta, që kanë për qëllim forcimin e kontakteve ndërmjet popujve dhe rritjen e besimit në shërbim të bashkëpunimit rajonal qytetar,
- Duke pasur parasysh se bashkëveprimi në të gjithë rajonin dhe bashkëpunimi midis të rinjve janë të një rëndësie vendimtare për të çuar më tej integrimin europian, promovimin dhe përhapjen e vlerave europiane, nxitjen e shpirtit europian, si edhe të kuptuarit e konceptit të Bashkimit Europian dhe rëndësisë e tij për qytetarët,
- Të vetëdijshëm se lidhjet më të ngushta mes të rinjve do të nxisin frymën e mirëkuptimit, tolerancës dhe miqësisë dhe duke pranuar faktin se rajoni mund të arrijë progres vetëm duke zbatuar parimet e barazisë, nëpërmjet veprimit të përbashkët dhe promovimit të përfshirjes, solidaritetit dhe bashkëpunimit,
- Të angazhuar për të përhapur dhe forcuar miqësinë mes të rinjve në rajon dhe promovuar dhe zbatuar e politikat, programet dhe aktivitetet e përbashkëta në zona që janë në interesin e drejtpërdrejtë të të rinjve,
- Duke ndjekur shembujt më të mirë europianë të përbashkët me hidhërimin e së kaluarës dhe duke parë përpara për një të ardhme më të mirë të ndërtuar mbi bashkëpunim rajonal dhe frymëzuar nga modeli i Zyrës Franko-Gjermane për Rininë,
- Duke pasur parasysh se bashkëpunimi i qëndrueshëm rajonal mes të rinjve është një mekanizëm i nevojshëm për të forcuar frymën e mirëkuptimit, tolerancës, miqësisë, dhe bashkëpunimit në rajon dhe më gjerë;
- Në dritën e Deklaratës së Përbashkët mbi Bashkëpunimin Rinor miratuar nga Ministrat e Punëve të Jashtme të Ballkanit Perëndimor në Tiranë, më 22 Maj 2015, dhe të Axhendës Pozitive për Rininë në Ballkanin Perëndimor, një nismë e lançuar gjatë Samitit të Brdos nga Ministrat e Punëve të Jashtme, më 23 Prill 2015

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Ø Të mbështesin shkëmbimin rinor rajonal dhe ndarjen e ideve të tyre, si hapësirë për bashkëpunimin e ardhshëm në rajonin tonë, bazuar në vlerat e bashkekzistencës, tolerancës dhe respektit për të drejtat e njeriut dhe diversitetin, si dhe në angazhimin për përfshirje dhe siguri,

Ø Të rrisin më tej bashkëpunimin rajonal mes të rinjve dhe institucioneve për rininë dhe të sigurojnë zbatimin e programeve rinore të përbashkëta me fokus parimet e qeverisjes demokratike, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, të arsimit dhe inovacionit,

Ø Të krijojnë Zyrën e Bashkëpunimit Rinor Rajonal të Ballkanit Perëndimor, si strukturë rajonale që drejton dhe koordinon bashkëpunimin e të rinjve në rajonin tonë,

Ø Të ngarkojnë institucionet kompetente të vendeve pjesëmarrësve, në bashkëpunim të ngushtë me Grupin e Punës për bashkëpunimin rinor rajonal, me hartimin e propozimeve konkrete që kanë të bëjnë me misionin, strukturën, aktivitetet dhe financimin e Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor, e cila do të përfundojë më 1 Mars 2016,

Ø Të mbështesin financiarisht krijimin dhe funksionimin e Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor;

Ø Të mbështesin pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile në punimet e Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor,

Ø Të kërkojnë fonde nga BE dhe shtetet anëtare, si dhe nga organizata ndërkombëtare dhe rajonale dhe donatorë për mbështetje të mëtejshme përmes mekanizmave ekzistuese të dhënies së fondeve.

Me synimin e :

Ø Promovimit të frymës së pajtimit dhe bashkëpunimit ndërmjet të rinjve në rajonin tonë duke hartuar programe të përbashkëta mbi vlerat më të mira dhe traditat kulturore të popujve tanë.

Ø Inkurajimit dhe mbështetjes së të rinjve në rajonin tonë për të luftuar dhe për t'u distancuar nga praktikat dhe fenomeni i racizmit, ksenofobisë, gjuha e urrejtjes, diskriminimi mbi baza etnie, feje dhe gjuhe amtare;

Ø Bashkëpunimit në fushën e arsimit akademik dhe shkencor duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet universiteteve, institucioneve akademike dhe shkencore.

Ø Promovimit të lëvizjes së të rinjve në rajonin tonë dhe në vendet anëtare të Bashkimit Europian, brenda programeve ekzistuese dhe skemave të lëvizshmërisë së studentëve.

Ø Hartimit dhe zbatimit të projekteve të përbashkëta në kuadrin e programeve europiane, si Erasmus +, Europa për Qytetarët, EASI, dhe të tjerë, në funksion të promovimit të shkëmbimeve të studentëve, praktikave, lëvizjes dhe projekteve të përbashkëta.

Ø Forcimit të aktivizimit dhe vullnetarizmit mes të rinjve, duke përfshirë vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet të rinjve dhe organizatave rinore të rajonit, si dhe mbështetjes së pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e vendimmarrjes.

Ø Krijimit të një platforme të përbashkët rajonale për të rinjtë për trajnimin shkencor dhe profesional në fushat e infrastrukturës së teknologjive të informacionit, turizmit, energjisë dhe bujqësisë, në përputhje me nevojat dhe prioritetet specifike kombëtare dhe rajonale.

Ø Promovimit të punësimit dhe sipërmarrjes së të rinjve duke paraqitur modele të praktikave të mira rajonale, si dhe inkurajimit të lëvizshmërisë për të fituar përvojë në punë/trajnim profesional dhe punësim.

Ø Krijimit të mekanizmave të përshtatshëm për zhvillimin e trajnimit profesional të të rinjve për t'ju përshtatur kërkesave dhe kriterëve të tregut të punës.

Ø Krijimit të kontakteve me organizatat simotra në Europë, në mënyrë që të organizohen veprimtari të përbashkëta me kontribut për paqen, pajtimin, integrimin dhe progresin.

Ø Inkurajimit dhe mbështetjes së aktiviteteve kulturore rinore duke pasur në fokus traditat më të mira rajonale dhe në artet moderne, si elementë të rëndësishëm për të rinjtë dhe bashkëpunimin mes popujve.

Ø Organizimit të aktivitete të përbashkëta për përmirësimin e cilësisë së shëndetit midis të rinjve.

Ø Organizimit të aktivitete të përbashkëta rinore për mbrojtjen e mjedisit dhe angazhimit vullnetar të të rinjve në aktivitetet për të mirën e shoqërisë.

Vjenë, më 27 gusht 2015